



Një 41-vjeçar është plagosur me armë zjarri në Bulqizë. Ngjarja ka ndodhur gjatë natës në një lokal, pas një konflikti.

Policia thotë se ka identifikuar dhe shpallur në kërkim autorin e dyshuar të ngjarjes, një 31-vjeçar me precedent kriminal, si dhe bashkëpunëtorin e tij.

"Rreth orës 02.40 në ambientet e një lokali në qytetin e Bulqizës, gjatë një konflikti të çastit është plagosur me armë zjarri shtetasi V.A, 41 vjeç, banues në Bulqizë, i cili ndodhet në spital aktualisht jashtë rrezikut për jetën.

[Download PPT...](#)[Infograpia.com](#)


Nga veprimet hetimore të kryera nga ekspert të Policisë ka rezultuar se autori i kësaj ngjarje është shtetasi I.D, 31 vjeç, banues në Bulqizë (person me precedent kriminal), i cili është larguar nga vendngjarja së bashku me shtetasin D.S. 24 vjeç", njofton policia.

Policia e Bulqizës në bashkëpunim me Specialistët për Hetimin e Krimit në DVP Dibër, po krehin zonën për kapjen e autorëve të kësaj ngjarje.

Vijon puna nga grupi hetimor, për dokumentimin e plotë të kësaj ngjarjeje.

[/portali DurresLajm/](#)

Na bëni like në facebook!:



Like 4

YOU MAY LIKE

DOWNLOAD PPT INFOGRAPHICS

[INFOGRAPIA.COM](#)

VLERAT E PROPOLISIT PËR SHËNDETIN. ANTIBIOTIK NATYRAL. I DUHURI PËR KËTË PERIUdhË QË PO KALOJMË